

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit të përqendrimit të parashtruar nga Sasol Investment Kompani (Ptu) Limited (Sasol Investment Company (Pty) Limited), me seli në Johannesburg, Afrika e Jugut, me një vend të aktivitetit të biznesit në Sasol Plejs 50 Ketrin Strit, Sandton, Goteng, 2146 Afrika e Jugut dhe Topsoe Proxhekt Investment A/S (Topsoe Project Investment A/S), me një vend të aktivitetit të biznesit në Haldor Topsoes Alle 1 (Haldor Topsoes Alle 1), 2800 Kgs. Lingbi, Danimarkë, nëpërmjet Shoqërisë së Avokatëve Debarliev, Dameski dhe Qeleshoska nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 20.09.2023, solli

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Sasol Investment Kompani (Ptu) Limited (Sasol Investment Company (Pty) Limited), me seli në Johannesburg, Afrika e Jugut, me një vend të aktivitetit të biznesit në Sasol Plejs 50 Ketrin Strit, Sandton, Goteng, 2146 Afrika e Jugut dhe Topsoe Proxhekt Investment A/S (Topsoe Project Investment A/S), me një vend të aktivitetit të biznesit në Haldor Topsoes Alle 1 (Haldor Topsoes Alle 1), 2800 Kgs. Lingbi, Danimarkë, do të themelojnë një sipërmarrje të përbashkët nën kontrollin e tyre të përbashkët, JV HoldKo dhe një sipërmarrje të përbashkët nën kontrollin e tyre të përbashkët, JV OEMKo, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës më 22.08.2023, , te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Komisioni) është dorëzuar një njoftim i përqendrimit nga Sasol Investment Kompani (Ptu) Limited (Sasol Investment Company (Pty) Limited),

me seli në Johannesburg, Afrika e Jugut, me një vend të aktivitetit të biznesit në Sasol Plejs 50 Ketrin Strit, Sandton, Goteng, 2146 Afrika e Jugut dhe Topsoe Proxhekt Investment A/S (*Topsoe Project Investment A/S*), me një vend të aktivitetit të biznesit në Haldor Topsoes Alle 1 (*Haldor Topsoes Alle 1*), 2800 Kgs. Lingbi, Danimarkë, me anë të së cilit Sasol Investment Kompani (*Ptu*) Limited dhe Topsoe Proxhekt Investment A/S do të themelojnë një sipërmarrje të përbashkët nën kontrollin e tyre të përbashkët, JV HoldKo dhe një sipërmarrje të përbashkët nën kontrollin e tyre të përbashkët, JV OEMKo.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Sasol Investment Kompani (*Ptu*) Limited është një shoqëri 100% e varur e Sasol Limited, Afrika e Jugut, e cila së bashku me shoqëritë e tjera të varura përbëhet nga „ Grupi Sasol “.

Grupi Sasol është një kimikat global (materiale të avancuara, kimikate bazë, kimikate esenciale të kujdesit dhe zgjidhje të performancës) dhe një grup energjis së kompanive (miniera, gaz dhe lëndë djegëse) me seli në Afrikën e Jugut që integron teknologjitë dhe proceset e sofistikuara në objektet operacionale të shkallës botërore. Grupi Sasol prodhon dhe shet produktet e tij me cilësi të lartë në 22 vende.

Në Maqedoninë e Veriut, Sasol Investment Kompani (*Ptu*) Limited është nuk ka regjistruar një prani korporative, XXX¹.

Topsoe Proxhekt Investment A/S është një shoqëri 100% e varur e Topsoe A/S, e cila së bashku me shoqëritë e saj të varura përbëhet nga „ Grupi Topsoe “. Topsoe Proxhekt Investment A/S prodhon dhe furnizon katalizatorë dhe licencon teknologjitë që lidhen me proceset e katalizës. Shoqëria ka dy lokacione prodhuese të vendosura në Frederiksund, Danimarkë dhe Hjuston, SHBA. Aktivitete që lidhen me inxhinierinë, kërkimin dhe zhvillimin e projekteve janë të vendosura në Sudzhou, Kinë; Lingbi, Danimarkë; Esen, Gjermani; dhe Nju Delhi, Indi.

XXX

JV HoldKo do të themelohet si një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar XXX

JV OEMKo do të themelohet si një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar XXX.

Qëllimi i biznesit të sipërmarrjes së përbashkët (i kryer nga kompanitë e Grupit JV dhe/ose SPV-të e pakicave) është të zhvillojë, ndërtojë, zotërojë dhe operojë objekte për prodhimin e karburantit të qëndrueshëm të avionëve që rrjedh nga lëndët e para jo fosile, duke përdorur hidrogjen të gjelbër, burime të qëndrueshme të CO2 dhe/ose biomasë dhe/ose lloje të tjera të karburanteve të aviacionit me karbon të ulët, me kusht që këto objekte të jenë projektuar në mënyrë që më shumë se 50% nga prodhimi përbëhet nga SAF (*Sustainable Aviation Fuel*) ose të jetë në gjendje të prodhojë një rezultat të përbërë nga SAF prej më shumë se 50%.

Përveç kësaj, JV HoldKo do të markojë, tregtojë dhe shesë SAF të prodhuar nga kompanitë e Grupit JV XXX.

¹ Të dhënat paraqesin fshehtësi afariste

Përveç kësaj, si një nënprodukt i pastër i prodhimit të SAF, JV HoldKo gjithashtu do të prodhojë dhe shesë XXX ose si shitje të kapura të Grupi Sasol, ose në treg.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски